



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 2469 / Prot.

Tiranë, më 27 / 6 / 2025

UDHËZIM

Nr. 1155, datë 27 / 6 / 2025

PËR

**PROCEDURAT E REKRUTIMIT NË SHËRBIM USHTARAK REZERVIST
NË FORCAT E ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13, pika 2, germa "f", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 2 të nenit 6, pikës 4 të nenit 8, të ligjit nr. 125/2024, datë 19/12/2024 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Hyrje.

Për plotësimin e Forcave të Armatosura me personel rezervist në zbatim të pikës 4 të nenit 8 të ligjit nr. 125/2024, datë 19/12/2024 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist në Republikën e Shqipërisë", rekrutimi për këtë kategori personeli rezervist përbën një sfidë për Forcat e Armatosura. Kjo do të arrihet nëpërmjet një sistemi rekrutimi dhe përzgjedhje transparente dhe të barabartë.

2. Qëllimi.

Udhëzimi "Procedurat e rekrutimit në shërbim ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura" përcakton parimet, objektivat, standardet, përgjegjësitë, procedurat dhe zbatimin e kritereve për rekrutimin e rezervistëve në Forcat e Armatosura.

3. Parimet.

Rekrutimi në shërbimin rezervist në Forcave të Armatosura do t'u ofrojë shanse të barabarta të gjithë ish ushtarakëve në rezervë/lirim, shtetasve shqiptar që shprehin dëshirë për përfshirje në këtë shërbim për mos diskriminim për shkak të racës, etnisë,

ngjyrës, gjinisë, përkatësisë fetare, vendbanimit, pagës, përfitimeve dhe kompensimeve të tjera, sipas kategorive të personelit.

Procedura e përzgjedhjes së rezervistit në shërbimin rezervist në Forcave të Armatosura do të jetë transparente dhe e dokumentuar. Për të rritur transparencën, procedurat, kriteret, udhëzimet, rregullat si dhe lista përfundimtare e e përzgjedhjes do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të Forcave të Armatosura.

4. Fusha e Zbatimit.

Kërkesat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e procedurave të shërbimit rezervist në Forcave të Armatosura, janë: Ministria e Mbrojtjes (Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve), Shtabi i Përgjithshëm i FA, Komandat e Forcave/Komandat Mbështetëse dhe komandat e njësisë dhe reparteve, Drejtoria e Personelit në SHP, Qendra e Personel Rekrutimit, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, Policia Ushtarake dhe Njësia Mjekësore Ushtarake.

5. Objektivat.

- a) Rekrutimi i rezervistëve është sfidë për Forcat e Armatosura. Aplikimi dhe organizimi i sistemit të përzgjedhjes për shërbimin rezervist në plotësimin e Forcave të Armatosura me rezervist sipas parashikimeve në Planin Afatgjatë të Zhvillimit të FA dhe Strategjinë Ushtarake;
- b) Inkurajimi i kandidatëve femra për përfshirjen e tyre në shërbimin rezervist në strukturat e FA;
- c) Nxitja e interesit të ushtarakëve në rezervë dhe shtetasve me specialitete të nevojshme për Forcat e Armatosura për në shërbimin rezervist, nëpërmjet zhvillimit të procedurave njohëse/marketingu sipas zonave ku ka më shumë nevojë për plotësim të reparteve prioritare.

6. Strukturat, autoritetet dhe përgjegjësitë.

6.1 Strukturat përgjegjëse për rekrutimin e shtetasve në FA janë:

- a. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DMBNJSH);
- b. Drejtoria e Personelit dhe Drejtoria e Operacioneve e Stërvitjes në SHP (J-1, J-3);
- c. Qendra e Personel Rekrutimit (QPR);
- ç. Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA (QKMBM&M);
- d. Komandat e Forcave/Komandat Mbështetëse (KF/KM);
- dh. Akademia e Forcave të Armatosura;
- e. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM)
- ë. Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes e Informacionit (ASNI)
- f. Policia Ushtarake (PU);
- g. Njësia Mjekësore Ushtarake e Forcave të Armatosura (NJMU);

- gj. Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA (BSHP);
- a) **Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM, përgjigjet për:**
- i. Përgatitjen e praktikave për miratimin e planit vjetor të rekrutim-mobilizimit të personelit të shërbimit ushtarak rezervist;
 - ii. përgatitjen e praktikave për titullim, gradim, emërim në detyrë të personelit oficer rezervist në Forcat e Armatosura, sipas kompetencave ligjore.
- b) **Drejtoria e Personelit dhe Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin Përgjithshëm të FA (J-1/J-3/7) përgjigjet për:**
- i. Hartimin e planit vjetor të rekrutim dhe dërgimin e tij për miratim tek Ministri Mbrojtjes;
 - ii. hartimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve e të përgjegjësisë të strukturave ushtarake për plotësimin e njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura me ushtarakë rezervistë dhe dërgimin e saj për miratim tek Ministri Mbrojtjes;
 - iii. hartimin e modeleve dhe dokumentacionit për evidentimin, identifikimin dhe përpunimin e të dhënave të shërbimit ushtarak rezervist që administrohet në Qendrën e Personel-Rekrutimit dhe në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe dërgimin e saj për miratim tek Ministri Mbrojtjes;
 - iv. përgatitjen e praktikave për rititullim, gradim, emërim në detyrë sipas kompetencave ligjore të personelit të personelit rezervist në Forcat e Armatosura.
- c) **Qendra e Personel-Rekrutimit përgjigjet për:**
- i. bashkëpunimin me QKMBM&M për publikimin në faqen e internetit të MM-së të procedurës, kriterëve, dokumentacionit dhe afatit të dorëzimit, për shërbimin ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura, sipas rajoneve;
 - ii. administrimin e dokumenteve të kandidatëve për shërbimin ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura, si dhe verifikimin e tyre me dosjet e personelit/e të dhënave në Sistemin e Automatizuar të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
 - iii. për zbatimin e planit të rekrutimit të personelit të shërbimit ushtarak rezervist;
 - iv. për sigurimin e personelit për shërbimin ushtarak rezervist, plotësimin e njësive e të reparteve të Forcave të Armatosura me personel rezervist sipas nevojave;
 - v. për hartimin dhe përditësimin e listës emërore të personelit në shërbimin ushtarak rezervist, brenda muajit janar të çdo viti;
 - vi. në bashkëpunim me strukturat e ministrisë për rendin dhe sigurinë publike, merr të dhëna nëpërmjet strukturave për gjendjen civile dhe çështjet e kufirit e të migracionit, njofton ndryshimet në regjistrin e gjendjes civile në lidhje me ndryshimin e shtetësisë, çregjistrim për shkak të vdekjes, adresat e banimit, si dhe largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë të ushtarakëve të shërbimit në rezervë, brenda 15 ditëve nga dita e dërgimit të kërkesës nga struktura përkatëse;
 - vii. përgatit dhe nënshkruan kontratat përkatëse me personelin e përzgjedhur për shërbimin ushtarak rezervist sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi;

- viii. i propozon shefit të Shtabit të Përgjithshëm modelet e dokumentacionit për evidentimin, identifikimin dhe përpunimin e të dhënave të shërbimit ushtarak rezervist që administrohet në Qendrën e Personel Rekrutimit dhe në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura;
- ix. dërgon pranë strukturës mjekësore ushtarake të Forcave të Armatosura listën e personelit ushtarak që do të kontrollohet për efekt të aktivizimit të tyre në shërbimin ushtarak rezervist;
- x. dërgimin në AISM, PU dhe MD (DPBurgjeve) të listës së kandidatëve për shërbimin ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura, me të dhënat e sakta personale, për vendbanimin, nëse janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi.

ç) Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA-së bashkëpunon me QPR për publikimin e njoftimit për shërbimin ushtarak rezervist dhe përgjigjet:

- i. për publikimin në faqen zyrtare të internetit të MM të njoftimit, procedurës, kriterëve, dokumentacionit dhe afatit të dorëzimit tyre në QPR, për rekrutimin në shërbimin ushtarak rezervist, sipas kategorisë së personeli dhe reparte, rajoneve.

d) Komandat e Forcave, strukturat mbështetëse dhe strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbështesin Qendrën e Personel Rekrutimit dhe përgjigjen:

- i. për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ushtrojnë detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me rregullore të veçantë, të miratuar nga ministri i Mbrojtjes.

dh) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU), përgjigjen: për kontrollin e plotësimit të kushtit nëse janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi. Kontrolli i verifikimit të kushtit të përfundojë brenda 30 ditëve nga dërgimi i listës nga Qendra e Personel Rekrutimit. Lista e verifikimit të kontrollit të plotësimit të kushtit të denimit nga AISM dhe PU, të dërgohen në J-l, ku të theksohet "plotëson kushtin e sigurisë për rezervist" dhe "nuk e plotëson kushtin e sigurisë për rezervist".

e) Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes e Informacionit(ASNI), përgjigjet:

- i. në bashkëpunim me QPR përgjigjet për hartimin dhe krijimin e infrastrukturës për regjistrimin, administrimin e të dhënave si dhe përpunimin statistikor në Sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për personelit ushtarak rezervist.

ë) Njësia Mjekësore Ushtarake e FA-së (NJMU), përgjigjet:

- i. Për ngritjen e komisionit mjekësor të kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore për pranim në shërbimin ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura. Përbërja e komisioneve, detyrat dhe përgjegjësitë përcaktohen në rregulloren përkatëse të aftësive fizike e shëndetësore të ushtarakut, të miratuar nga ministri i Mbrojtjes dhe ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë;

- ii. për kryerjen e kontrollit të aftësive të shtetasit për pranim në shërbimin ushtarak rezervist, pranë Spitalit Universitar të Traumës, sipas listës së personelit ushtarak që do të kontrollohet për efekt të aktivizimit të tyre në shërbimin ushtarak rezervist.
- f) **Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të mbështesë Qendrën e Personel Rekrutimit** gjatë fushatës marketingut dhe gjatë procesit të përzgjedhjes të kandidatëve për rekrutim në shërbimin rezervist, sipas kërkesave të QPR.

II. PROCEDURAT PËR REKRUTIM NË SHËRBIMIN USHTARAK REZERVIST

1. Procedurat e planifikimit për rezervist.

- a) Në periudhën Janar të çdo viti, Komandat e Forcave, strukturat mbështetëse dhe strukturat e tjera të Forcave të Armatosura që kanë strukturë rezerviste paraqesin pranë Drejtorisë së Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (J-1), nevojat dhe kërkesat për kompletimin e Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve me personel ushtarak rezervist të nevojshëm për vitin, sipas prioriteteve, kategorive të personelit, reparteve, etj.
- b) Drejtoria e Personelit dhe Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA (J-1, J-3), mbi bazën e nevojave dhe kërkesave, harton planin vjetor për kompletim të strukturës rezerviste si dhe planin e aktivizimit të forcave rezerviste për zhvillimin e stërvitjeve e të veprimtarive të tjera të Forcave të Armatosura.

2. Kriteret e përgjithshme në shërbimin ushtarak rezervist.

Për rekrutimin në shërbimin ushtarak rezervist, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të mos jetë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
- c) të jetë i moshës:
 - i. deri 50 vjeç për ushtar;
 - ii. deri 55 vjeç për nënoficer;
 - iii. deri 60 vjeç për oficer.
- d) të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjyqimi;
- e) të jetë vlerësuar i aftë për ushtarak aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;
- f) të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

3. Procedurat e aplikimit për rekrutim në shërbimin ushtarak rezervist.

- a) Ushtaraku në shërbimin në rezervë apo shtetasi që dëshiron të bëhet pjesë e shërbimit ushtarak rezervist në FA si oficer, nënoficer dhe ushtar/detar, do të aplikojnë: online, si dhe pranë Qendrës së Personel Rekrutimit.
- b) aplikantët plotësojnë formularët e aplikimit dhe pranimin të dokumentacionit brenda afatit përcaktuar;

- c) procedura, kriteret, dokumentet, rregullat e përzgjedhjes bëhen publike në faqen e internetit të MM.
- 4. Regjistrimi i kandidatëve për rekrutim në shërbimin ushtarak rezervist, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR.**
- 4.1 Dokumentacioni që do të paraqesin për regjistrim është:**
- kërkesë me shkrim për pranim në shërbimin ushtarak rezervist;
 - vërtetimin e karrierës ushtarake si ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura të lëshuar nga Qendra e Personel Rekrutimit, origjinal ose fotokopje e noterizuar;
 - vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, nga Prokuroria e Rrethit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), origjinal ose fotokopje të noterizuar.
 - formularët e vetëdeklarimit gjyqësor, të pastërtisë së figurës, ndryshimeve në gjerënalitete, shoqëruar, kur është e mundur, me dokumentet provuese;
 - dokumenti i aftësisë për punë i qendrës shëndetësore të lëshuar nga mjeku i familjes si dhe ekzaminimet mjekësore, grupin e gjakut të lëshuar nga drejtoritë e shëndetit publik ose laborator mjekësor të licencuar për këto analiza;
- 4.2** Shtetasi shqiptar që nuk ka qenë më përpara, pjesë e shërbimit aktiv dhe pranohet në shërbimin ushtarak rezervist, paraqet krahas dokumenteve të përcaktuara në pikën 4.1, edhe fotokopje e noterizuar e dëftesës/diplomës shkollës/universitetit, së bashku me listën e notave.
- 5. Komisionet dhe përbërja e tyre.**
- 5.1** Komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pranim në shërbimin ushtarak rezervist përbëhet jo më pak se 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të Komandantit QPR.
- 5.2** Komisioni funksionon pranë Qendrës Personel Rekrutimit brenda kohës përcaktuar në urdhrin përkatës për çdo vit kalendarik. Komisioni kryen procedurën e përzgjedhjes bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur ku përfshihet: arsimimi/kualifikimi, trajnimi, eksperiencë/përvoja në punë. Përparësi në përzgjedhjen e personelit rezervist kanë kandidatët ushtarak që ka dalë në rezervë nga shërbimi aktiv, moshë dhe arsimim/kualifikimi sipas kategorisë së personelit. Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas meritës për secilën kategori personeli. Përzgjedhja e personelit rezervist bëhet sipas kategorisë së personelit në përputhje me nevojat organike dhe kapacitetet e strukturave rezerviste të Forcave të Armatosura.
- 5.3** Komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pranim në shërbimin ushtarak rezervist, kur është e nevojshme, kërkon SHPPFA-së që ta mbështesë me personel nga struktura ku është ushtaraku është caktuar si rezervist.
- 5.4** Komisioni i Ekzaminimit Shëndetësor funksionon në Njësinë Mjekësore Ushtarake, Tiranë, sipas urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.
- 5.5** Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ngrihet pranë QPR për verifikimin e ankesave të paraqitura.
- 5.6** Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, përbëhet nga:
- Përfaqësues nga SHP (J1), kryetar;
 - Përfaqësues nga QPR , anëtar;
 - Përfaqësues nga struktura ku është ushtaraku është caktuar si rezervist, anëtar;
 -

5.7 Ekzaminimet shëndetësore të kandidatëve rezervist.

- 5.7.1 Ekzaminimi shëndetësor i kandidatëve për rezervist kryhet nga personeli i Njesisë Mjekësore Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës, sipas listës së dërguar nga komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit.
- 5.7.2 Në përfundim të ekzaminimeve të kryera, komisioni mjekësor i NJMU-së, vendos nëse kandidati është i aftë për rezervist në Forcat e Armatosura ose jo. Kandidatët që rezultojnë të paaftë nga ana shëndetësore nuk mund të pranohen si rezervist në FA. Gjykimi i përcaktuar nga Komisioni Mjekësor i NJMU-së është përfundimtar.
- 5.7.3 Brenda dy ditëve nga përfundimi i kontrollit shëndetësor, Njësia Mjekësore Ushtarake i dërgon me shkrim QPR emrat dhe raportet mjekësore të kandidatëve për rezervist në FA.

6. Procedura e ankimimit.

- 6.1 Kandidatët kanë të drejtë që, brenda 2 ditëve nga shpallja e rezultateve, të ankohen me shkrim në Qendrën e Personel Rekrutimit në lidhje me vlerësimin.
- 6.2 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit, shqyrton ankesat brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit të ankimimit dhe i kthen përgjigje me shkrim të interesuarave brenda 24 orëve nga përfundimi i shqyrtimit të ankesave.
- 6.3 Procedura e zgjidhjes së ankesave dokumentohet zyrtarisht.

7. Procedura përzgjedhjes përfundimtare/shpallja e fituesve.

- 7.1 Konsiderohen fitues të gjithë kandidatët që kanë përfunduar të procedurat e përzgjedhjes dhe që kanë rezultuar të aftë nga ana shëndetësore pas ekzaminimit mjekësor. Renditja e rezultateve përfundimtare bëhet sipas kategorive të personelit.
- 7.2 Raporti i rezultateve përfundimtare të zhvilluar nga Komisioni i vlerësimit për rezervist shpallet nga QPR në një vend të dukshëm pranë QPR-së ose në faqen e internetit të MM, brenda 24 orëve nga përfundimi i shqyrtimit të ankesave.
- 7.3 QPR sipas planit të dërguar nga SHSHPFA, mbi bazën e raportit të rezultateve përfundimtare, dërgon në Drejtorinë e Personelit në SHPFA, listën e kandidatëve fitues që janë përzgjedhur për rezervist në FA.
- 7.4 J-1 në SHPFA, në përputhje me planin e rekrutimit vjetor të rezervistëve sipas kompetencave ligjore dërgon propozimet për kategorinë oficer në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe përgatit urdhrat SHSHPFA për rititullim, gradim dhe emërim në detyrë për kategorinë nënoficer dhe për ushtarët/detarët aktiv.

8. Procedurat e titullimit, gradimit dhe emërimit të ushtarakut në shërbimin rezervist

- 8.1 Ushtaraku në rezervë, me përfshirjen e tij në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura, titullohet dhe i jepet grada ushtarake që ai ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura.
- 8.2 Shtetasi shqiptar që nuk ka qenë më përpara, pjesë e shërbimit aktiv dhe pranohet në shërbimin ushtarak rezervist, ditën e titullimit ushtar, nënoficer dhe oficer

rezervist, kryen betimin ushtarak. Formula e betimit përcaktohet sipas statusit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8.3 Titullimi, gradimi dhe emërimi në detyrë bëhet sipas kompetencave ligjore e nënligjore në fuqi, sipas kategorisë personelit rezervist me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, sipas listës së kandidatëve fitues të për zgjedhur për rezervist në FA nga komisioni përkatës në QPR.

8.4 Emërimi në detyrë i personelit rezervist bëhet me propozim të komandantit të Forcës/Komandës Mbështetëse/AFA, komandantit/drejtuesit repartit autonom.

8.5 Një kopje e urdhrave të titullimit, gradimit dhe emërimit në detyrë të personelit të shërbimit rezervist dërgohet në çdo strukturë ushtarake ku është caktuar organikisht, si dhe në QPR, për t'u administruar në dosjen personale të ushtarakut të shërbimit rezervist.

9. Kontrata për shërbim ushtarak rezervist

9.1 Me pranimin në shërbim ushtarak rezervist lidhet kontratë shërbimi me Forcat e Armatosura. Kontrata për shërbim ushtarak rezervist nënshkruhet midis rezervistit të Forcave të Armatosura sipas përcaktimit në germën “d”, nenit 23 të ligjit nr. 125/2024, datë 19/12/2024 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist në Republikën e Shqipërisë” dhe komandantit të Qendrës Personel Rekrutimit, për një periudhë jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak rezervist, sipas modelit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.

10. Dispozita të Fundit.

10.1 Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi: komandantët e Forcave, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandanti i AFA-së, komandantët e reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë të MM dhe të SHPPFA, Qendra e Personel-Rekrutimit, Policia Ushtarake, AISM, Njësia Mjekësore Ushtarake, Drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA.

10.2 Ndjekin zbatimin e këtij udhëzimi shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe sekretari përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Bashkëlidhur;

- Formulari i kërkesës për pranim në shërbimin ushtarak rezervist;
- Formulari i aplikimit për ushtar/nënoficer/oficer në shërbimin ushtarak rezervist
- Formular vetëdeklarimi;
- Formular vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore të kandidatit për shërbim ushtarak rezervist;
- Formular i pranimin të dokumentacionit për shërbimin ushtarak rezervist;

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Pirro Vengu

FORMULARI I KËRKESËS
PËR PRANIM NË SHËRBIMIN USHTARAK REZERVIST

Unë i nënshkruari (emër, atësi, mbiemër) _____ i datëlindjes

_____, lindur në _____, e banues në _____

me Nr. ID/Pasaportë _____, kërkoj të pranohem për shërbim ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura.

1. Ushtarak që ka dalë në rezervë nga shërbimi aktiv:

- Grada _____
- Vjetërsi në shërbim _____.

2. Shtetas civil:

- ☐ Me arsim të lartë
- ☐ Me arsim të mesëm
- ☐ Me arsim të nëntëvjeçar

KËRKUESI

(emër, atësi, mbiemër, firmë)

Adresa: _____

Nr. Tel: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

FORMULARI I APLIKIMIT

PËR USHTAR/NËNOFICER/OFICER NË SHËRBIMIN USHTARAK
REZERVIST

A) TË DHËNAT PERSONALE:

1. Emër:Atësi:Mbiemër:
2. Nr. i Kartës së Identitetit:
3. Gjinia: Mashkull ☐ Femër ☐ Gjatësia:
4. Datëlindja:Vendlindja:Vendbanimi:
5. Kombësia: Shtetësia:

B) ADRESA/KONTAKT:

1. Adresa e vendbanimit:
2. Numri i Telefonit: Fiks:Cel:
3. E - mail:

C) TË DHËNA MBI ARSIMIMIN:

1. Arsimi i kryer:
 - ☐ Me arsim të lartë;
 - ☐ Me arsim të mesëm;
 - ☐ Me arsim të nëntëvjeçar.
2. Lloji i arsimit parauniversitar:
 - ☐ I përgjithshëm
 - ☐ Profesional
3. Institucioni arsimor ku keni kryer arsimin:

.....
(shëno emërtimin e shkollës, qytetit/fshatit)

4. Lloji arsimit të lartë:
 - ☐ Ushtarak Specialiteti
 - ☐ Civil Dega

5. Diploma që zotëroni:

☐ Bachelor

☐ Master Profesional

☐ Master Shkencor

6. Universiteti/Fakulteti

7. Koha e kryerjes së studimeve të lartë:

.....

Lexoni me kujdes secilën pyetje dhe vendosni shënjën “x” në njërën nga kolonat e mëposhtme, **PO** ose **JO**.

D) TË DHËNA SHITESË:

PYETJET		PO	JO
Pyetja 1	A keni ndryshuar gjeneratatet (emrin, mbiemrër, emri i nënës) etj		
Pyetja 2	A keni shtetësi tjetër përveç asaj shqiptare?		
Pyetja 3	A keni shërbyer më parë në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë?		
Pyetja 4	A keni aplikuar ndonjëherë tjetër për të shërbyer në Forcat e Armatosura?		
Pyetja 5	A jeni këshilluar ndonjëherë me psikolog apo mjek psikiatër?		
Pyetja 6	A jeni në marrëdhënie pune?		
Pyetja 7	Nëse keni qenë herë tjetër në marrëdhënie pune dhe jeni larguar prej saj.		
Pyetja 8	A keni njohuri në ndonjë gjuhë të huaj ?		
Pyetja 9	Jeni i gatshëm të pranoni për të shërbyer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në operacione ushtarake ndërkombëtare?		
Pyetja 10	Do të dëshironit që ta zhvillonit edhe më tej karrierën tuaj?		
Pyetja 11	A keni qenë i depërtuar ndonjëherë nga vendet e tjera?		

E) MOTIVI QË JU SHTYN TË SHËRBENI SI USHTARAK NË SHËRBIMIN NË REZERVË

Shkruani me shkrim dore me rreth 100 fjalë përse dëshironi të shërbeni si rezervist në Forcat e Armatosura.

Përsa më sipër, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se informacioni që kam shënuar në këtë formular aplikimi është i vërtetë, i saktë dhe është dhënë me vullnetin tim të lirë. Jam i hapur ndaj autoriteteve kompetente për të bërë verifikimin e nevojshëm.

APLIKANTI

(emër, atësi, mbiemër, firmë)

Adresa: _____

Nr. Tel: _____

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri	
Atësia/Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:

- a) ☐ i/e padënuar. ☐ i/e dënuar.
- b) ☐ i/e pandaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale.
☐ i/e ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale.
- c) ☐ pa masë shtrënguese të sigurisë personale,
☐ me masë shtrënguese të sigurisë personale,

Nëse po, specifiko të dhënat e mëposhtme:

- ☐ ndalim i daljes jashtë shtetit.
- ☐ detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore.

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër, Mbiemër / Firmë

Emër, Mbiemër / Firmë / Vullë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

**FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR GJENDJEN SHËNDETËSORE TË
KANDIDATIT PËR SHËRBIM USHTARAK REZERVIST**

Emri _____ Atësia _____ Mbiemri _____

Datëlindja ____ . ____ . ____

Nr.	Probleme shëndetësore	Po	Jo
1.	A keni marrë goditje në kokë këto 5 vitet e fundit?		
2.	A keni patur ndonjë tronditje në kokë këto 5 vitet e fundit ?		
3.	A keni patur ndërhyrje kirurgjikale dentare brenda muajit të fundit ?		
4.	A keni kryer ndërhyrje kirurgjikale në trupin tuaj?		
5.	A keni pasur thyerje të kockave të ndryshme të trupit brenda 1 viti?		
6.	A keni marrë apo jeni duke marrë mjekim kundër përdorimit të alkolit apo substancave narkotike të ndryshme ?		
7.	A keni ndonjë shqetësim neurologjik apo psikologjik që lidhet me mirëfunksionimin e organizmit tuaj?		
8.	A keni pasur ndonjë shqetësim shëndetësor në zemër apo të tensionit arterial?		
9.	A keni pasur apo keni ndonjë çrregullim apo infeksion të organeve të dëgjimit (veshit) dhe frymëmarrjes (hundës) në muajin e fundit ?		
10.	A keni pasur problem të tjera shëndetësore (nëse po specifikoj problemin) ?		

Nënshkrimi

(Emri Atësia Mbiemri)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

FORMULAR I PRANIMIT
TË DOKUMENTACIONIT PËR SHËRBIMIN USHTARAK REZERVIST

I. TË DHËNA PERSONALE:

- Emri: Atësia: Mbiemri:
- Datëlindja: Vendlindja: Vendbanimi:.....
- Numri i kartës së identitetit:

II. VERIFIKIMI I DOKUMENTACIONIT.

Specialistët e Seksionit të Mobilizimit të QPR, pasi verifikuan pyetësorin e aplikimit për shërbim ushtarak rezervist, të plotësuar nga aplikanti, si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e tij, konstatojnë se:

- ☐ Aplikanti ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të udhëzimit.
- ☐ Aplikanti nuk ka dorëzuar: _____
(specifikohet dokumentacioni që nuk ka paraqitur ose parregullsitë e vërejtura)

- ☐ Aplikanti plotëson kriteret për vijimin e procedurave.
- ☐ Aplikanti nuk plotëson kriteret për vijimin e procedurave.

(specifikohen shkaqet e mosplotësimit të kriterëve)

Me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme, bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikanti _____, si më poshtë:

(Emër, Atësi, Mbiemër)

1. Kërkesë me shkrim;
2. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
3. Dy fotografi të përmasave 4 x 6;
4. Dy fotografi të përmasave 9 x 12;
5. Fotokopje e noterizuar dëftesës/ diplomës shkollës/universitetit.
6. Fotokopje diplome/dëshmi/certifikatë për aftësi profesionale të noterizuar (nëse ka).

7. Fotokopje leje drejtim automjeti të noterizuar (nëse ka);
8. Dokument i qendrës shëndetësore të lëshuar nga mjeku i familjes.
9. Ekzaminimet mjekësore për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut;
10. Formularin e aplikimit për shërbim ushtarak rezervist;
11. Formularin e pranimit të dokumentacionit të aplikantit;
12. Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes shëndetësore,
13. Dëshmi penaliteti;
14. Vërtetim gjykatë;
15. Vërtetim Prokurorie.

Specialisti i Mobilizimit

(_____)
(Gradë Emër Mbiemër Nënshkrimi)

Aplikanti

(_____)
(Emër Mbiemër Nënshkrimi)

Shënim: Dokumentacioni i aplikantit i plotësuar pranë Qendrës së Personel Rekrutimit nga aplikanti, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar prej tij, është pjesë e pandarë e dosjes personale të kandidatit për shërbim ushtarak rezervist.

Tiranë , më ____ . ____ .202_